

ILIRIA TREKKING

AKT THEMELIMI

Shoqëri me përgjegjësi te kufizuar

Sot, më datë 07.06.2023, në Tirane Znj.Oliva Carrasco Toribio, shtetas Spanjolle, me zotësi juridike të plotë për të vepruar, i datëlindjes 29/06/1981, mbajtëse e dokumentit të identifikimit me numër pasaporte spanjolle PAN579438, nënshkroi këtë akt themelimi të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar me emër **ILIRIA TREKKING**.

Neni 1

Forma e shoqërisë

Ortaku themelon një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në kuptimin që përgjegjësia e tyre është e kufizuar deri në shumën e kapitalit të derdhur, pa iu njohur asnjë përgjegjësi tjetër.

Neni 2


Emërtimi i shoqërisë

Emërtimi i shoqërisë është **ILIRIA TREKKING**

Neni 3

Baza juridike

Shoqëria ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin Shqiptar dhe në përputhje me dispozitat e statutit dhe aktit të themelimit të saj.



Neni 4

Objekti i veprimtarisë

4.1 Shoqëria **ILIRIA TREKKING** përcakton objektin e saj si më poshtë:

4.2 Objekti i veprimtarive të Shoqërisë është pa kufizim, dhe do të përfshijë, por pa u kufizuar, aktivitete turistike të çdo lloji apo tipi, importi, eksporti, tregtia me shumicë dhe pakicë e mallrave, sipërmarrja dhe shërbimi në fusha të ndryshme; kryerja e transaksioneve në lidhje me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, kryerja e veprimtarive dhe/ose pjesëmarrja në çdo veprim ose aktivitet në përputhje me ligjet, dhe çdo aktivitet ekonomik që do të konsiderohet i nevojshëm dhe i dobishëm në mënyrë që të përmbushet qëllimi i veprimtarisë, dhe që nuk bie në kundërshtim me legjislacionin shqiptar. Në përputhje me legjislacionin shqiptar, në mënyrë që të arrihet qëllimi i sipërpermendur, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tregtar, financiar, dhenie-marrje me qera, të vendosë pengje dhe barre hipotekore, etj.

4.3 Shoqëria, me vendim të administratorit, mund të lidhë marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo sipërmarrje të tjera, si dhe të kryejë çdo veprimtari tregtare që konsiderohet e nevojshme me qëllim arrijtjen e objektit të saj.

4.4 Për të realizuar qëllimet e saj, shoqëria mund të sigurojë dhe përdorë financime nga ortakët, nga vende të tjera si dhe nga institucione financiare vendase ose të huaja.

4.5 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë mund të ndryshojë, të zgjerohet apo të kufizohet në bazë të vendimit të ortakut.

Neni 5

Selia

Shoqëria **ILIRIA TREKKING** ka selinë në adresën:

Tirane, Selite, Zona Kadastrale 3292 Nr i pasurisë 153/116+3-6 Vol 25 Faqe 149.

Në këtë adresë do të ushtrohet aktiviteti kryesor i shoqërisë.

Neni 6

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohore të pa përcaktuar.



Neni 7

Kapitali i shoqërisë

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100 (njëqind) lekë.

Neni 8

Administrimi

Administrator i shoqërisë do te jete:

Znj.Oliva Carrasco Toribio, person me shtetësi shqiptare, i datëlindjes 29/06/1981, mbajtës i dokumentit të identifikimit me numër personal PAN579438. Afati i emertimit të administratorit do të jetë për një periudhe 5 vjecare nga 07/06/2023 deri në 07/06/2028 me të drejtë riemërimi.

Neni 9

Viti financiar

Vitet financiare përputhen me vitin kalendarik. Viti financiar fillon në 1 Janar dhe mbyllet në 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik. Përrjashtimisht, viti i parë financiar do të fillojë nga data e regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar dhe do të mbyllet në fund të vitit përkatës.

Neni 10

Të ardhurat neto

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakëve themelues të shoqërisë në raport me kuotat e tyre në kapital. Të ardhurat që do të rezultojnë në fund të mbylljes së çdo viti ushtrimor, në përputhje me parashikimet e statutit dhe pas shlyerjes së detyrimeve tatimore dhe rezervës së domosdoshme, te konkretizuara në pasqyrat dhe raportet financiare të çdo viti financiar, mund te



ndahen ndërmjet ortakëve në raport me pjesët që ata zotërojnë në kapitalin e shoqërisë, ose mund të ri investohen si kapital i shoqërisë.

Neni 11

Juridiksioni

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së shoqërisë, do të zgjidhen me mirëkuptim. Në rast të kundërt, kompetente për zgjidhjen e tyre janë gjykatat shqiptare.

Ky akt themelimi i shoqërisë **ILIRIA TREKKING** me përgjegjësi të kufizuar është hartuar në 1 (një) kopje në gjuhën Shqipe dhe pasi lexohet, nënshkruhet nga ortaku themelues.

Ortaku i Shoqërisë: ILIRIA TREKKING

Oliva Carrasco Toribio

OLIVIA CARRASCO TORIBIO

